



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji,
Kulturë, Rini e Sport
Mbledhja nr. 36
Prishtinë, më 25.11.2009 ora 10:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës
Salla nr. C- 301

P R O C E S V E R B A L

nga mbledhja e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport

Në mbledhje morën pjesë: Agim Veliu, Drita Kadriu, Mark Krasniqi, Heset Cakolli, Arsim Rexhepi, Donika Kadaj-Bujupi dhe Dragan Dimiq.
Munguan Enis Kervan dhe Memli Krasniqi.

Nga sekretaria e Kuvendit morën pjesë: Lule Ymeri dhe Drita Çarkaxhiu.

Në mbledhje morën pjesë ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit Valton Beqiri, Burbuqe Deva, udhëheqëse e Divizionit për Trashëgiminë Kulturore ne MKRS dhe Arbnore Riza zyrtare nga MKRS.

Në mbledhje nuk mori pjesë përfaqësuesi i Ministrisë së Administratës Publike, i cili ishte i ftuar nga ana e Komisionit.

Në mbledhje prezantuan përfaqësuesi i KDI-së, dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit.

.

Mbledhjen e udhëhoqi Agim Veliu, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje është paraparë ky:

Rend dite

1. Këshilli i Kosovës për Trashëgiminë Kulturore

Rendi i ditës u miratua nga anëtarët e Komisionit.

Agim Veliu -kryetar, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes.

Kryesuesi tha se në bazë të Përfundimit të Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe shkresës së ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me qëllim të sqarimit të rolit dhe detyrave të Këshillit të Kosovës për Trashëgiminë Kulturore, Komisioni ka mbajtur mbledhje me përfaqësuesit e Këshillit të Kosovës për Trashëgiminë Kulturore, si dhe ka ftuar ministrin e Kulturës Rinisë dhe Sportit, që të jap opinionin e tij lidhur me funksionimin e Këshillit.

Komisioni në bazë të Ligjit do të nxjerrë një Rekomandim të cilin do t'ia dërgojë Kryesisë së Kuvendit, MKRS, KKTK dhe MAP.

Kryesuesi lidhur me këtë pikë të rendit të ditës fjalën ia dha ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit Valton Beqiri.

Valton Beqiri ministër, tha se në pajtim me Ligjin për Trashëgiminë Kulturore neni 4.8 është formuar Këshilli i Kosovës për Trashëgiminë Kulturore si organ i themeluar nga Kuvendi i Kosovës me mandat tre vjeçar.

Në kuadër të MKRS ekziston Divizioni për Trashëgiminë Kulturore dhe struktura organizative institucionale në kuadër të Këshillit të Kosovës për Trashëgiminë Kulturore.

Ai shprehi shqetësimin se vendet e shpallura të punës me konkurs publik për 9 zyrtarë të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore janë një veprim i njëanshëm i pakoordinuar me të cilin synohen të krijohen institucione paralele në kundërshtim me Ligjin, duke cekur në kuadër të ministrisë ekziston struktura organizative qëllim të funksionimit dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturore të Kosovës.

Në këtë kontest shpalljen e konkursit nga ana e Këshillit të Kosovës për Trashëgiminë Kulturore e sheh si një dyfishim të pozicioneve që pengon procesin institucional dhe krijon paralelizma institucional që e ngarkojnë Buxhetin e Kosovës.

Ai tha se Ministria është e gatshme që të bashkëpunojë me të gjitha mekanizmat me qëllim të funksionimit dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturore të Kosovës.

Drita Kadriu tha se në shoqëritë demokratike ekzistojnë mekanizma rregullativë që janë të pavarura dhe që krijojnë aktivitete të caktuara. Sa i përket mënyrës organizative të Këshillit kërkon sqarim nga ministri a konsiderohet ky Këshill rival apo paralel i zyrës së Ministrisë. Ajo ceku se Rekomandimi i Komisionit do të jetë i bazuar në Ligj.

Valton Beqiri ministër lidhur me këtë tha se ministria nuk e konsideron këtë Këshill rival të tij, nga fakti se vet e ka iniciuar themelimin e tij. Ministria e konsideron Këshillin e Trashëgimisë Kulturore si Organ të pavarur të themeluar sipas Ligjit me rol dhe detyra këshillëdhënëse, që duhet të bashkëpunojë me Ministrinë dhe Institutet që janë në vartësi të Ministrisë si Instituti Arkeologjik, Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve, Muzeu i Kosovës etj.

Mark Krasniqi tha se nëse konsiderohet se ka kolezion në mes të Këshillit dhe Ligjit duhet të shqyrtohet mundësia e amendamentit të Ligjit për Trashëgimisë Kulturore.

Donika Kadaj- Bujupi konsideron se Këshilli është organ i pavarur i themeluar sipas Ligjit nga Kuvendi i Kosovës dhe si i tillë për punën e tij duhet t'i raportojë Kuvendit.

Mendon se për funksionim të tij Këshilli duhet të ketë një staf teknik administrativ që do të shërbente ne kryerjen e punëve teknike.

Heset Cakolli tha se Këshilli është organ i cili është themeluar nga Kuvendi dhe për punën e tij i përgjigjet Kuvendit, nga takimi i Komisionit me përfaqësuesit e Këshillit, është konfirmuar mbështetja nga ana e divizionit të trashëgimisë kulturore e MKRS për këtë Këshill.

Ai kërkon sqarim nga ministri se me çfarë numri të stafit mund të funksionojë ky Këshill.

Arsim Rexhepi tha se Këshilli është themeluar nga Kuvendi i Kosovës, dhe ka karakter këshillëdhënës. Kërkon sqarim nga ministri a mund të funksionojë Këshilli me stafin aktual që është në kuadër të Divizionit të Trashëgimisë Kulturore në mënyrë që të mos krijohen implikime buxhetore të panevojshme, apo të zgjerohet Këshilli me një staf përcjellës, dhe sa është korelati apo ndryshimi i pagës i zyrtarit të Këshillit nga pozita e njëjtë në Divizionin për Trashëgiminë Kulturore që është në kuadër të MKRS.

Valton Beqiri ministër në vazhdim tha se Ministria është e përkushtuar që të përkrahë punën e Këshillit e jo të pengojë atë.

Ai ceku se amendamenti i Ligjit për Trashëgiminë Kulturore do të zgjedhë disa nga problemet që janë krijuar me këtë rast.

Sa i përket ndryshimit të pagës ndërmjet pozitës së zyrtarit të Divizionit të Trashëgiminë Kulturore të Ministrisë dhe atij të propozuar nga Këshilli vërehet një proporcion shumë i madh që është 1:3 kjo dhe krijon mospajtime në mes të zyrtarëve të Ministrisë .

Burbuqe Deva, udhëheqëse e Divizionit për Trashëgiminë Kulturore në MKRS tha se Këshilli është organ profesional i përbërë nga vet anëtarët e tij. Këshilli duhet të përkrahët dhe të funksionojë me ndihmën e një stafi teknik, por jo edhe një stafi profesional ngase do të krijoheshin paralelizma institucional gjë që do të ketë ndikim negativ në punën e Këshillit..

Sa i përket Divizionit të Trashëgimisë Kulturore ajo tha se ky Divizion duhet të ngritet në kuadër të Departamentit që është një ndër pikat kryesore të Këshillit të Evropës.

Anëtarët e Komisionit Heset Cakolli, Donika Kadaj Bujupi janë të mendimit që Këshilli i Kosovës për Trashëgiminë Kulturore është Organ që mund të themelojë Komisione të caktuara kohë pas kohe sipas veprimtarisë së punës, dhe që duhet të ketë një staf teknik administrativ, ndërsa kontestojnë formimin e stafit profesional ngase konsiderohet se vet anëtarët e Këshillit janë staf profesional dhe me këtë rast do të dyfishoheshin pozititat.

Kryesuesi Agim Veliu tha se me nenin 4.8 i Ligjit për Trashëgiminë kulturore parashihet roli dhe detyrat e Këshillit. Me Rregulloren e miratuar nga Këshilli i Kosovës për Trashëgiminë Kulturore parashihet formimi i stafit të këtij Këshilli. Komisioni pas dëgjimit të palëve lidhur me këtë çështje nxori këtë:

R e k o m a n d i m

1. Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore është themeluar nga Kuvendi i Kosovës sipas Ligjit për Trashëgiminë Kulturore.

2. Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore është organ këshilldhënës dhe profesional i cili ka për objekt të veprimtarisë fushën e trashëgimisë kulturore.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së tij, Këshilli mund të formojë Komision ad hoc, dhe të bashkëpunojë me Institucionet kompetente për Trashëgimi Kulturore.
4. Komisioni konsideron se për funksionimin e veprimtarisë së tij Këshilli duhet të ketë një staf teknik të punës.
5. Kërkesa e Këshillit për staf profesional të cilin e kërkon në bazë të konkursit publik konsiderohet se është e pabazë, ngase vet Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore përbëhet nga ekspertët e lëmive të trashëgimisë kulturore.

Rekomandimi i Komisionit i dërgohet Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, Ministrisë së Administrimit Lokal dhe Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore

Mbledhja e Komisionit përfundoi në orën 11,20.

Kryetari i Komisionit

Agim Veliu